

# **RAST STUDIMI:** **Gjuhë e urrejtjes me bazë gjinore gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024 në Maqedoninë e Veriut**

# RAST STUDIMI: Gjuhë e urrejtjes me bazë gjinore gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024 në Maqedoninë e Veriut

**G**jatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024 në Maqedoninë e Veriut është vërejtur një angazhim politik në rritje në platformat e mediave sociale, me diskurs të nxehtë të drejtuar shpesh ndaj kandidatëve femra. Ky rast studimi shqyrton prevalencën dhe natyrën e gjuhës së urrejtjes gjinore në internet, duke u fokusuar vetëm në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024.

Duke shfrytëzuar të dhënat e [platformës online të gjuhës së urrejtjes EOOH](#), janë analizuar gjithsej 1634 (n=1634) mesazhe, të mbledhura nga data 1 mars deri më 20 qershor, duke mbuluar si periudhën parazgjedhore ashtu edhe atë paszgjedhore. Hulumtimi, i kryer nga Instituti i Studimeve të Komunikimit (ICS) në bashkëpunim me Textgain (Textgain), synonte të vlerësonte nivelet e gjuhës së dëmshme dhe toksike drejtuar këtyre kandidatëve në platformat Facebook dhe X (Twitter).

## Gjetjet kryesore

Shumica e mesazheve që përmbanin gjuhë toksike i kanë drejtuar kandidatës për kryetare të VMRO-DPMNE-së, Gordana Siljanovska-Davkova. Është interesant fakti se kandidatja e partisë politike E Majta, Biljana Vankovska, nuk iu nënshtrua të njëjtave sulme siç ishte rasti me Siljanovska-Davkova. Ky dallim mund t'i atribuohet faktit se Vankovska nuk ka avancuar në raundin e dytë të zgjedhjeve dhe se ajo nuk ka qenë e lidhur me asnjërën nga dy partitë kryesore politike, VMRO-DPMNE apo LSDM.

Përafërsisht 2% e mesazheve të analizuara përmbanin dezinformata, ndërsa 1% përfshinin kërcënime. Këto mesazhe ishin veçanërisht shqetësuese pasi kishin potencialin të ndikonin në perceptimin e publikut nëpërmjet gënjeshtreve ose të frikësonin individët e përfshirë në procesin politik.

## Prevalenca e “gjyshes Goga”

Një nga ofendimet më të përdorura ndaj Gordana Siljanovska Davkovës ishte “Gjyshja Goga”<sup>1</sup>, e cila ishte shfaqur në komente të shumta. Ky term nuk ishte vetëm një fyerje për moshën e saj, por gjithashtu kishte shërbyer si një mjet për talljen e përfshirjes së saj politike, duke e krahasuar shpesh me politikanë meshkuj, si presidenti i SHBA Joe Biden, në një mënyrë nënçmuese. Për shembull, një mesazh thoshte:

*“Gjëja më e fortë është që vmro-vistët tallen me Bidenin se është plak, kurse admirojnë gogën senile dhe krenare, të humbur në kohë dhe hapësirë. VMRO-ja është një diagnozë! Sekt!”*

Ky koment tallej me moshën dhe përkatësinë e saj politike, duke nënvizuar kryqëzimin e seksizmit, moshës dhe përçmimit politik. Duke e inkuadruar Siljanovska Davkovën si një grua të moshuar pa kontakt, sharje të tilla dëmtojnë diskursin nga politikët dhe kualifikimet e saj në attribute personale që nuk kanë lidhje me aftësitë e saj si udhëheqëse. Komentet e tjera ndoqën shembullin:

*“Goga krenare është gjyshe, nuk është e përshtatshme për presidente”.*

*“Është gati o e mjera, pse po e mërzit, gjyshe, shko në shtëpi, jo në studio televizive...”*

*“Çfarë mëkati është baba goga, Zoti na ndihmoftë”.*

Komentuesit shpesh e quanin atë si “senile”, duke përdorur moshën dhe pamjen e saj si pika talljeje, ndërkohë që tallnin edhe përkatësitë e saj politike. Një komentues shkroi, “VMRO-ja e mori gjyshen Goga në një takim në EPP si një nuse e re”, duke sugjeruar se pjesëmarrja e saj ishte thjesht ceremoniale dhe duke hedhur poshtë agjencinë e saj politike.

Analiza zbuloi se **mesazhet toksike janë më të përhapura në Facebook**, ku u gjetën 55% e të gjitha mesazheve jashtëzakonisht toksike (të gjitha kishin një rezultat toksiciteti më të madh se 0.8). X, edhe pse është një platformë me përmbajtje të dëmshme, sërish duket se përmban më pak mesazhe tejet toksike dhe kjo ndoshta për shkak të politikave më të rrepta të moderimit të kësaj platforme, por edhe numrit dukshëm më të ulët të përdoruesve në vend në krahasim me Facebook.

## Pse tallja e dëmton diskursin

Përdorimi i ofendimeve si “Gjyshe Goga” e redukton diskursin politik në komente të vogla dhe të dëmshme. Në vend që të përfshihen në një debat kuptimplotë rreth politikave apo platformave të kandidatëve, këto mesazhe përforcojnë stereotipet negative për gratë në politikë, veçanërisht për gratë e moshuara.

---

1. Termi "Baba Goga" sugjeron që personi është i keq, frikësues ose armiqësor. Është një lojë fjalësh për "Baba Roga", një personazh mitik i përfaqësuar në folklor si një plakë e keqe që tremb ose rrëmben fëmijët.

Fyerjet bazuara në moshë dhe seksiste si këto zhvlerësojnë kontributet e një kandidati bazuar vetëm në gjini dhe moshë, duke minuar përfshirjen e proceseve politike. Një retorikë e tillë ngulfat dialogun konstruktiv dhe përjetëson një kulturë ku kandidatet femra gjykohen nga karakteristikat personale dhe jo nga idetë dhe kualifikimet e tyre.

Një pjesë e konsiderueshme e gjuhës së urrejtjes kundër Siljanovska Davkovës ishte e lidhur me mbështetjen e saj nga VMRO-DPMNE, duke shtuar një shtresë politike në retorikën seksiste. Një numër i madh komentesh kombinuan fyret politike me ofendimet gjinore dhe kështu krijuan një sulm të dyfishtë – **kundër përkatësisë së saj politike dhe kundër përkatësisë së saj gjinore**. Për shembull, ajo shpesh akuzohej si “tradhtarë” dhe talleshin për lidhjen e saj me VMRO-DPMNE-në, të cilën disa komentues e lidhën me paaftësi apo korrupsion. Një model i tillë i diskursit seksist të ngarkuar politikisht ishte një nga më të pranishmit në analizë.

## Vështrimet dhe përfundimet kryesore

Gjetjet ilustron një model shqetësues të gjuhës së urrejtjes gjinore në diskursin politik, veçanërisht që synon kandidatet femra më të vjetra si për shembull Gordana Siljanovska Davkova. Përdorimi i shpeshtë i termave si “Gjyshe Goga” shërben për të banalizuar rolin e saj në peizazhin politik, duke e zhvendosur fokusin nga platforma e saj politike dhe duke e reduktuar kandidaturën e saj në një temë talljeje bazuar në moshën dhe gjininë e saj. Kjo nuk është vetëm e dëmshme për të personalisht, por edhe e dëmshme për cilësinë e përgjithshme të debatit politik.

Biljana Vankovska, në të kundërt, ishte kursyer shumë nga gjuha e urrejtjes gjinore, e mundshme për shkak të daljes së saj të hershme nga gara dhe mungesës së lidhjes së saj me partitë politike dominuese, gjë që sugjeron se politika partiake, në kombinim me seksizmin, luan një rol kyç në vëllimin dhe intensitetin e gjuhës së urrejtjes në internet.

Ky rast studimi tregon rëndësinë e monitorimit dhe adresimit të gjuhës së urrejtjes gjinore, veçanërisht gjatë periudhave të ngjyrosura politikisht siç janë zgjedhjet. Kombinimi i dëmshëm i seksizmit, moshës dhe fyerve politike të parë në këtë studim nënvizon nevojën për praktika më të forta moderimi në platformat e mediave sociale dhe përpjekje më të fuqishme për të promovuar diskursin politik të respektueshëm.

## Metodologjia e përdorur

### Grumbullimi i të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave mbështetej në platformën e gjuhës së urrejtjes në internet EOOH, e cila monitoronte ndërveprimet kryesisht në Facebook dhe X (Twitter). Për analizë janë përzgjedhur gjithsej 1634 mesazhe. Këto mesazhe u mbledhën nga seksionet e komenteve dhe jo nga postimet zyrtare të bëra nga partitë politike apo vetë kandidatët, duke siguruar një fokus në diskursin publik. Platforma ka përdorur mjete/vegla të automatizuara, në lidhje me mbikëqyrjen njerëzore, për të nxjerrë mesazhe përkatëse që përfshinin elementë toksikë. Këta elementë u identifikuan në bazë të kategorive të paracaktuara si **sharje, fyerje, tallje, përbuzje, racizëm, seksizëm, politikë, fe, kërcënime dhe të pavërteta**.

Analiza e toksicitetit në mesazhet në internet janë kryer duke përdorur mjetet e avancuara të përpunimit të gjuhës Textgain, të cilat matin intensitetin e ndjenjës negative në tekst. Textgain cakton një pikë toksiciteti për çdo mesazh, duke filluar nga 0 deri në 1, me një rezultat më të lartë që tregon një nivel më të rëndë toksiciteti. Mesazhet me rezultate mbi 0.8 klasifikoheshin si jashtëzakonisht toksike. Mesazhet u analizuan më tej për fjalë kyçe dhe fraza specifike toksike që përdoren zakonisht në kontekstin e gjuhës së urrejtjes kundër kandidatëve femra. Platforma gjithashtu ka monitoruar shpeshësinë dhe kombinimet e kategorive të ndryshme toksike.

## Kategoritë toksike të analizuara

Janë shqyrtuar elementët e mëposhtëm toksikë në kontekstin e mesazheve drejtuar kandidatëve presidencialë:

- **Sharje/Shprehje vulgare:** Përdorimi i gjuhës vulgare që ka për qëllim poshtërimin e kandidatëve.
- **Tallje:** Komentet që kanë për qëllim talljen e kandidatëve, shpesh bazuar në gjininë ose moshën e tyre.
- **Përbuzje:** Shprehje përbuzjeje ose mosrespektimi, shpesh e lidhur me karakteristika politike ose personale.
- **Racizëm:** Edhe pse më pak i zakonshëm, mesazhe të caktuara përmbanin sharje ose referenca etnike.
- **Seksizëm:** Fyerje ose komente gjinore që kanë për qëllim minimin e kandidatëve për shkak të gjinisë së tyre.
- **Politikë:** Ofendime të ngjyrosura politikisht, shpesh të lidhura me përkatësitë e VMRO-DPMNE-së apo LSDM-së.
- **Fe/Religjion:** Referencat ndaj fesë në një kontekst nënçmues ose poshtërues.
- **Kërcënime:** Mesazhe që përmbajnë dhunë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar.
- **Të pavërteta:** Dezinformata ose pretendime të rreme për kandidatët.



**ИС** Институт за  
комуникациски  
студии

НЕ ВЕРУВАЈ  
**ПРОВЕРУВАЈ!**  
#користифакти 